

## DEKLARATA E AUTORIT

Mbiemri: .....

Emri: .....

Adresa: .....

Vendi dhe data e lindjes: .....

Shtetësia: .....

si autori dhe pronari i vetëm i të drejtave të autorit të fotografisë me titull (e identifikuar) ..... (tash e tutje e quajtur “Vepra”) jap këtë deklaratë (tash e tutje e quajtur “Deklarata”) në vendin dhe datën e përmendur më poshtë, e cila do të konsiderohet obligim i njëanshëm dhe i parevokueshëm me sa vijon:

Deklaroj se jam plotësisht i vetëdijshëm dhe pranoj rregullat e konkursit ndërkombëtar të fotografisë të quajtur "Konkursi për Dekadën e Integritit të Romëve" të organizuar nga Instituti për Shoqëri të Hapur (tash e tutje të quajtur OSI) dhe Arkivit të Shoqërisë së Hapur në Universitetin e Evropës Qendrore (tash e tutje të quajtur Arkivi OSA). Gjithashtu deklaroj se jam plotësisht i vetëdijshëm se OSI dhe Arkivi OSA kanë për qëllim ta ekspozojnë, t'ia tregojnë publikut, ta botojnë në një libër dhe ta përdorin në mënyra të ndryshme Veprën të cilën unë e kam paraqitur në konkurs.

Deklaroj dhe e siguroj OSI-n dhe Arkivin OSA dhe palët e treta të cilat kërkojnë të drejta, leje, apo autorizim për të përdorur Veprën time në bazë të kësaj Deklarate se Vepra është krijim i imi origjinal me të gjitha të drejtat e autorit dhe se nuk ka ndonjë palë të tretë, të drejtat, pronësia, apo interesat e së cilës do të pengonin ose kufizonin ushtrimin e të drejtave, lejeve, ose autorizimeve të marra nga OSI dhe Arkivi OSA në bazë të kësaj Deklarate, se dhe të drejtat e palëve të treta të angazhuara nga OSI dhe Arkivi OSA. Rjedhimisht, angazhohem të garantoj tani dhe në të ardhmen OSI-n dhe Arkivin OSA dhe palët e treta të angazhuara nga ata ndaj çdo pretendimi të palëve të treta si rezultat i përdorimit të Veprës nga ana e OSI-t apo palëve të treta të angazhuara nga ajo në bazë të kësaj Deklarate, nëse ato pretendime bazohen në të ashtuquajturat të drejtat ekonomike ose morale të autorit apo në çfarëdo të drejta të tjera pronësore apo të drejta të përgjithshme morale.

Deklaroj dhe e siguroj OSI-n dhe Arkivin OSA se foto-modelet që paraqiten në Vepër janë pajtuar që të paraqiten në të; Vepra i është treguar foto-modeleve dhe ato kanë dhënë pajtimin e lartpërmendur. Rjedhimisht, angazhohem të garantoj tani dhe në të ardhmen OSI-n dhe Arkivin OSA dhe palët e treta të angazhuara nga ata ndaj çdo pretendimi të palëve të treta që dalin nga shkëlja e garancisë së mësipërme. Angazhohem që, në raste të tilla, të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të siguruar pëlqimin e foto-modeleve.

Me nënshkrimin e kësaj Deklarate, në mënyrë të parevokueshme i jap OSI-t dhe OSA-s leje të transferueshme që të përdorë Veprën time për qëllime jofitimprurëse pa ndonjë kufizim në lidhje

me kohën, vendin, ose sasinë e përdorimit, por të kufizuar për përdorim të Veprës vetëm brenda konkursit dhe për nevojat e tij, ne lidhje me këto të drejta:

- të drejtën e riprodhimit të Veprës në tërësi apo pjesërisht në çfarëdo mediumi, analog apo dixhital, në mënyrë të përhershme apo të përkohshme, direkt apo indirekt, përfshirë regjistrimet zanore dhe vizuale të Veprës dhe riprodhimin e saj në katalogje, udhërrëfime të shkurta, të tjera botime promovuese, media të shtypura dhe elektronike dhe shtyp, përmbledhje veprash, baza të të dhënave, dhe multimedia;

- të drejtën e shpërndarjes së Veprës dhe të gjitha shpërndarjet e mëpastajme në çfarëdo transmetuesi apo mediumi, dixhital apo analog, duke përfshirë shpërndarjen e Veprës në çfarëdo lloj transmetuesi zanor apo vizual, katalogje, udhëpërshkrime të shkurtëra dhe botime të tjera promovuese në çfarëdo transmetuesi, përfshirë mediat elektronike dhe shtypin, përmbledhje të veprave, baza të të dhënave dhe multimedia të vendosura në transmetuesë dixhitalë ose analogë;

- e drejta e komunikimit të Veprës publikut në çfarëdo mënyre teknike, përfshirë transmetimet analoge, dixhitale, ose satelitore apo me kabël, si dhe komunikim on-line me kërkesë përmes rrjetave kompjuterike (interneti, për shembull) apo rrjete të tjera komunikimi, si dhe përfshirë të drejtën e ritransmetimit të Veprës së emituar duke e riemituar, apo dërguar me kabël ose sistemeve televizive IP;

- të drejtën e ekspozimit të Veprës, përfshirë paraqitjen e Veprës në emituesë dixhitalë apo analogë, ekrane televizive apo terminale.

Deklaroj se përdorimi i Veprës sime jashtë mënyrave të përshkruara në këtë Deklaratë do të përcaktohet me një marrëveshje të veçantë.

Që kjo Deklaratë të hyje në fuqi në mënyrë të rregullt, angazhohem të nënshkruaj të gjitha deklaratat shtesë të nevojshme, me shkrim ose me gojë, me kërkesë dhe harxhime të OSI-t dhe OSA-s, që mund të nevojiten nën ndonjë legjislacion tjetër, në mënyrë që kjo Deklaratë të njihet si e plotfuqishme dhe e aplikueshme në vendin në të cilën Vepra përdoret.

Deklaroj se e mbaj të drejtën që emri im të shënohet në dhe në lidhje me Veprën time.

Deklaroj se pajtohem përfundimisht dhe në mënyrë të përvokueshme që OSI dhe Arkivi OSA mund të mbledhin, të ruajnë, administrojnë, dhe transmetojnë të dhënat e mija vetëm në përputhje me kushtet e cekura dhe gjatë tërë kohës që kërkon konkursi, që do të thotë: a) gjatë expozitës së fotografive, përfshirë fotografitë fituese dhe b) për një afat të caktuar prej tre vitesh. Mund të lejoj OSI-n dhe/ose Arkivin OSA t'i bëjnë të njohura detajet e mija të kontaktit në raste individuale palëve të treta vetëm me pëlqimin paraprak timin apo të kujdestarit tim legal.

Konfirmoj se pjesëmarrja ime në konkurs bëhet përmes pranimit nga OSI (H-1051 Budapest, 12 Tetor 6. Utca, Hungari) të Deklaratës sime të nënshkruar nga unë, prindi apo kujdestari legal (nëse jam i moshës jomadhore sipal ligjit në legjislacionin ku jetoj) dhe dy dëshmitarë. Konfirmoj se Deklarata do të shtypet dhe do të nënshkruhet nga unë sipal këtyre kushteve dhe do t'i dërgohet OSI-së më postë (H-1051 Budapest, 12 October 6. utca, Hungary) ose me faks [(+361) 327-3260].

Konfirmoj se e pranoj ligjin hungarez kompetent në lidhje me interpretimin e Deklaratës dhe lejeve të lëshuara sipas kësaj Deklarate. Në rast të ndonjë kontesti ligjor i cili nuk do të mund të zgjidhet në mënyrë miqësore në mes meje dhe OSI-t dhe/ose OSA-s, e pranoj kompetencën ekskluzive të Gjykatës Metropolitane Hungareze.

Deklaratën e kam nënshkruar me vullnetin tim të lirë në çdo aspekt.

Nëse sipas ligjit në fuqi nën legjislacionin nën të cilin unë jetoj unë jam nën moshën madhore për të marrë obligime ligjore personalisht, konfirmoj se prindërit ose kujdestarët e mi janë pajtuar me pjesëmarrjen time në këtë konkurs duke iu përmbajtur kësaj Deklarate të shtypur.

Vendi: .....

Data: ....., 2008

Autori:

Jam prindi ose kujdestari ligjor i fëmijës së moshës jomadhore nënshkrimi i të cilit është në këtë Deklaratë dhe kështu jap pëlqimin tim që fëmija të marrë pjesë në këtë konkurs si dhe i paraqes të gjitha të dhënat e mia personale të kërkuara me konkurs dhe për ekzekutimin e kësaj Deklarate.

Vendi: .....

Data: .....

Prindi:

---

Dëshmitari:

---

Dëshmitari:

---